



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:016557

Datë: 05.12.2018

Numri i dokumentit: 00199495

P. nr.341/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarit T. M. nga fshati L. Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378/8-6 të KPRK-së, sipas Aktakuzës të Prokurorisë Themelore- DP në Gjakovë, PP.nr.1767/2017 të dt.14.05.2018, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **05.12.2018**, në prani të Prokurorit të shtetit Ismet Tofaj dhe të akuzuarit T. M., të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **T. M.**, nga fsh. L. K-Gjakovë, i biri i Xh. dhe i nënës Gj. e gjinisë F., data e lindjes në fshatin L. Komuna e Gjakovës, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, atë i 5 fëmijëve, bujk, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, nr. ID

Ë s h t ë f a j t o r

Sepse :

- **me dt. 12.11.2017 rreth orës 12:00 në fshatin L.** Komuna e Gjakovës, duke drejtuar mjetin e punës- traktorin e markës “...” ngjyrë hiri, pa targa, nga rruga dytësore, kyçet në rrugën kryesore e nuk u jep përparësi automjeteve me përparësi kalimi, e vepron në kundërshtim me nenin 61 par. 5/4 të Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, rrezikon trafikun publik e jetën e njerëzve e pasurinë nga pakujdesia, edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet nga veprimi apo mos veprimi i tij e me mendjelehtësi mendon se nuk do të shkaktohet, ose do e parandalojë dhe pasoja është shkaktuar, në atë mënyrë që me të arritur me traktor në rrugën kryesore B. – D. nxiton e nga rruga e dheut – dytësore kyçet në rrugën kryesore e ia merr përparësinë e kalimit automjetit i cili po qarkullonte në rrugë kryesore, ashtu që me gomën e parë djathtas të traktorit në pjesën ballore e godet automjetin e markës “..” tipi “...” me targa të regj., ngjyrë vishnje metalike, pronë e B. K. nga fshati L. K- Gjakovë, e dëmton traktorin të cilin e drejtonte, ndërsa të dëmtuarit I. (B). S. nga Gjakova, rr. “...” nr...., i shkakton dëm material në automjet si dhe pasagjeres së tij në automjet të dëmtuarës S. S. nga Gjakova, Rr. ““...” nr...., i shkakton lëndime të rënda trupore, të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore të Dr. N. U. të datës 07.02.2018.

-me çka ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378/8-6 të KPRK-së.

Andaj Gjykata në bazë të nenit 4,17,41,49,50,51, 73 ,neni 378/8-6 të KPRK-së dhe nenit 365 të KPP, të akuzuarit i shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej **1(një) vit**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej **2 (dy) viteve**, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

Të dëmtuarit S. S. dhe I. S. për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën prej **71.10 €** (në emër të ekspertizës së komunikacionit 51.10 euro dhe 20.00 euro në emër të ekspertizës mjekoligjore) si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej **20,00 €**, në afat prej **15 ditëve**, pasi Aktgjykimi të marrë formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë .

Mbikëqyrjen e periudhës verifikuese të dënimit me kusht do ta bënë Shërbimi Sprovues i Kosovës Dega në Gjakovë .

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP.nr.1767/2017 të dt. 14.05.2018 e ka akuzuar të akuzuarin T. M. nga fshati L. Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378/8-6 të KPRK-së, duke propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor, të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në pagesën e shpenzimeve procedurale.

Gjatë shqyrtimit fillestar me dt.05.12.2018, përfaqësuesi i PTH-DP, në Gjakovë, Prokurori Ismet Tofaj, lexon aktakuzën PP.nr.1767/2017 të dt.14.05.2018 dhe deklaron se mbetet në tërësi pranë aktakuzës.

I akuzuari T. M., gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me parë pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion me qenë se aksidenti ka ndodhur nga pakujdesia, kërkoj falje nga të dëmtuarit për lëndimet e shkaktuara, premtoi se në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm, shtoi se ditën kritike kam qëndruar në vendin e ngjarjes dhe vet e kam ftuar policinë, po ashtu të dëmtuarin S. S. së bashku me të dëmtuarin I. e kemi ndihmuar dhe e kemi bartur në spitalin e Gjakovës me një automjet të një kalimtari të rastit, andaj i propozoi gjykatës që të marrë parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë, pendimin e shprehur në gjykatë si dhe faktin se është hera e parë që kam ra në ndesh me ligjin të me shqiptojë një dënim me të butë.

Prokurori i shtetit Ismet Tofaj deklaron se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë pasi që i njëjti është i vetëdijshëm për pasojat dhe favorët juridike të pranimi të fajësisë dhe se aktakuza ka mbështetje në provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Ne tërësi u vërtetua se i akuzuari T. M. : me dt. 12.11.2017 rreth orës 12:00 në fshatin L. Komuna e Gjakovës, duke drejtuar mjetin e punës – traktorin e markës “....” ngjyrë hiri, pa targa, nga rruga dytësore, kyçet në rrugën kryesore e nuk u jep përparësi automjeteve me përparësi kalimi, e vepron në kundërshtim me nenin 61 par. 5/4 të Ligjit nr. 05/L-088 për Rregullat e Trafikut Rrugor, rrezikon trafikun publik, jetën e njerëzve e pasurinë, nga pakujdesia, edhe pse ka qenë i vetëdijshëm se pasoja e ndaluar mund të shkaktohet nga veprimi apo mos veprimi i tij e me mendjelehtësi mendon se nuk do të shkaktohet, ose do e parandalojë dhe pasoja është shkaktuar, në atë mënyrë që me të arritur me traktor në rrugën kryesore B. – D. nxiton e nga rruga e dheut – dytësore kyçet në rrugën kryesore e ia merr përparësinë e kalimit automjetit i cili po qarkullonte në rrugë kryesore, ashtu që me gomën e parë djathtas të traktori në pjesën ballore e godet automjetin e markës “....” tipi “....” me targa të regjistrimit, ngjyrë vishnje metalike, pronë e B. K. nga fshati L. K- Gjakovë, e dëmton traktorin të cilin e drejtonte, ndërsa të dëmtuarit I. (B). S. nga Gjakova, rr. “...” nr..., i shkakton dëm material në automjet si dhe pasagjeres së tij në automjet të dëmtuarës S. S. nga Gjakova, rr. “....” nr..., i shkakton lëndime të rënda trupore, të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore të Dr. N. U. të datës 07.02.2018.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të se cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPPK-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit. Rrethana rënduese gjykata e konsideron faktin se i akuzuari ka kryer veprën penale të rrezikimit të trafikut publik nga neni 378/8-6 të KPRK-së të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh personalitetin e të pandehurit se është baba i 5 fëmijëve, pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari në çdo fazë të procedurës, sjelljen korrekte në gjykim, shprehjen e keqardhjes dhe kërkim falja nga të dëmtuarit, faktin se i akuzuari më parë nuk ka qenë i dënuar. Në këtë drejtim ka ndikuar veçanërisht personalitetin e tij që të gjykata është kuptuar si njeri i sjellshëm, korrekt dhe i vetëdijshëm për pasojat e shkaktuara, të cilat rrethana ndikuan që gjykata të zbatoj dispozitat e zbutjes se dënimit të parapara në nenin 73 të KPRK-së, gjykata të akuzuarit i shqiptojë dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afat prej 2 (dy) viteve, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale, do të arrihet efekti dhe qëllimi dënimit dhe ky dënim sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer, shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se me shqiptimin e sanksionit të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në dispozitivin e nenit 41 të KPRK-së, se kjo do të ndikoj tek i akuzuari që në të ardhmen të mos kryejë vepra penale, si dhe do të ndikojë tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi për udhëzimin e palës se dëmtuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike është marr bazuar në nenin 463/2 te KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 te KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi .

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,
P. nr.341/18 më datë 05.12.2018.**

**Sekretarja juridike,
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,
Ilirjana Hoti**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi mund të paraqitet ankesë ,në afatin prej **15 ditësh** ,nga dita e marrjes së tij në dorëzim Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:016557
Datë: 05.12.2018
Numri i dokumentit: 00199495